

## THESAR I PASUR LEKSIKO-FRAZEOLOGJIK DHE ETNOLINGUISTIK NGA NJË AREAL I VEÇANTË I SHQIPES

**Bahtiar KRYEZIU<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> Faculty of Education, University of Gjilan „Kadri Zeka“

(Gjovalin Shkurtaj: “*Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolingustik i Malësisë së Madhe*” ASH e Shqipërisë, Tiranë, 2021)

*Atje, në viset e thella malore, jeton ende  
fjala e pashkruar e gjuhës sonë të bukur.  
Deri aty ku ka arritur asfalti nuk gjejmë  
gjë, duhet të futemi më thellë - thoshte*

*prof. dr. Abdullah Zymberi*

Që nga botimi i veprës “*Fjalor latinisht-shqip*” (1635) i Frang Bardhit, e sidomos nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe në dy dhjetëvjetëshat e këtij shekulli, dy akademitë tona dhe institucionet shkencore, deri më sot kanë sjellë në dritë me dhjetëra fjalorë shqip, fushash të ndryshme. Vjet ASH e Shqipërisë botoi veprën madhore të prof. dr. Ali Jasharit “*Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*”, me 814 faqe, kurse nga dje (më 30 mars 2022) këtij vargani fjalorësh iu bashkua edhe vepra “*Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolingustik i Malësisë së Madhe*” e akademikut Gjovalin Shkurtajt, studiues i madh i shqipes, në fushën e gramatikës, drejtshkrimit, dialektologjisë, sociolingustikës, entolingustikës, onomastikës, po edhe të leksikografisë etj.; autor e bashkautor i afro 40 veprave të botuara e ndonjë të ribotuar.

**Për të hartuar këtë fjalor, akademik Gjovalin Shkurtaj, vuri në veprim tërë potencialin e tij krijues-shkencor për të vjelë këtë pasuri të heshtur për sa kohë e për t’i dhënë zë e fuqi një thesari të pasur leksikor, nga një areal aq burimor me fjalë e shprehje të gjakut e të mishit të shqipes, e të cilin nga tashti mund ta kemi në duar.**

Dija albanologjike e sidomos leksikografia shqiptare, me daljen në dritë të veprës “*Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolingustik i Malësisë së Madhe*”, u pasurua edhe me një vepër madhore e të rëndësishme për ne, me prurje shumë të vlefshme nga një e folme e veçantë, me lëndë shumë të pasur leksikore, frazeologjike dhe etno-folklorike e sociolingustike. Nga *Parashtresa* e veprës së akademik Gjovalinit mësojmë që ai të ketë thënë: “*Këtë fjalor leksikor dhe frazeologjik e kam ideuar e nisur ta hartoj qysh në fillesat e punës sime si dialektolog në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë, e pikërisht në janar të vitit 1969*”<sup>43</sup>, pra, nga më se gjysmë shekulli kohë të kaluar, deri me rastin e botimit të këtij fjalori.

<sup>43</sup> Shkurtaj, Gjovalin, *Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolingustik i Malësisë së Madhe*, Tiranë, 2021, faqe 5.

Se kishte bërë një punë shumë të madhe deri me rastin e daljes në dritë të kësaj vepre me mbi 1000 faqe, autori i *fjalorit* në fjalë na e kujton këtë në *Fjalën paraprijëse, ku thotë*: “...kam bërë hartim e rivështrime të pjesëve të tij gati çdo ditë “me kohë të pjesshme”, gjithnjë duke gjetur fjalë e frazeologjizma që duheshin përfshirë në të. Por, kur ia behu e padëshirueshmja pandemi e Covid-19, mbylles së detyrueshme e ngujimit në shtëpi, më në fund, i dhashë një motivim duke iu kthyer plotësisht e redaktimit përfundimtar të “*Fjalorit*”, tashmë “me kohë të plotë”, qysh nga ora gjashtë e mëngjesit e deri në mbrëmje vonë”.

Se ç’mund e djersë ka derdhur në punën e vet, në një fushë mjaft komplekse e të mundimshme, akademiku ynë e dëshmon edhe me fjalët e dijetarit e filologut të shquar, J. C. Scaliger (1484-1558), i cili ka shkruar: “Nëse kërkon që ta torturosh dikë, mos e urdhëro të rrahë metalin në farkëtari, as mos e dërgo në punë të rënda në miniera, por jepi më mirë të bëjë fjalorë; kjo punë është më e rëndë se të gjitha llojet e mundimeve të tjera”. “*Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe*” është një vepër që ka mbështetje në hulumtimet dhe studimet paraprake të akademik Shkurtajt, nga ajo trevë për të cilën i biri i asaj ane ka dashuri e mall të pashuar edhe sot, duke e pasuruar këtë vepër me fjalë e shprehje të reja gjatë rrjedhës së moteve.

Siç shihet edhe nga inventari i eksploruar në terren, akademikut tonë, krahë e inspirim për të botuar këtë *fjalor* i dhanë, padyshim, monografia e tij e parë për të folmen e Kastratit<sup>44</sup>, një skicë për të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit<sup>45</sup>, si dhe monografitë për Hotin<sup>46</sup>, Kelmendin<sup>47</sup>, Rranxat e Mbishkodrës<sup>48</sup>, etj\*. Është kjo lëndë e eksploruar, me ngadalë, kujdes e sens prej një eksperti të rrallë të dialektologjisë shqiptare. Me fjalë të tjera, është ky një korpus fjalësh prej mbi 12300 leksemash, nga ato të folme rurale, ku shqipja flitet bash shqip.

Sado që këto të folme, me gjithë shtrirjen e gjerë tokësore, me afritë që kanë e që përbëjnë thuaja një tërësi territoriale e gjuhësore gati unike, secila trevë ka edhe të veçantat e veta, “disa dallime e luhatje brendapërbrenda”, andaj edhe studimet dialektologjike të bëra nga akademik Shkurtajt janë bërë për secilën tërthore veç e veç. Leksemat e paraqitura në *fjalor*, me pak përjashtime, janë fjalë me burim të shqipes, shumicën nga të cilat fjalorët e shqipes nuk i kanë, e që një numër syresh mund të futen, si prurje të reja, në *Fjalorin e madh të shqipes*, i cili sapo ka nisur hapat e tij të parë, në botim të ASH të Shqipërisë, me në krye të grupit punues, leksikografin tonë të madh, akademik Jani Thomain, ndihmuar edhe nga 10 ekspertë të tjerë, ndër të cilët edhe autori i kësaj vepre, akademik Govalin Shkurtajt, prof. dr. Valter Memisha dhe leksikologë, dialektologë, etimologë, semantologë, e leksikografë të tjerë, si dhe disa studiues të shqipes nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, arbëreshët e Italisë etj.

Në *fjalor* është përfshirë një korpus i përfillshëm me mbi 12300 fjalë, siç theksuam më sipër, që shprehin realie të ndryshme: emërtime njerëzish, frymorësh të botës shtazore, insekte, fjalë nga flora, fjalë që shprehin veprime të ndryshme, emra farefisnie, frazeologjizma, emra gjeografikë që shënojnë: ara, livadhe, përrrenj, kroje, mrize, lëndina, kodra, lugje, roga, udhë,

<sup>44</sup> Gjovalin Shkurtajt, *E folmja e Kastratit*, “Studime filologjike”, nr. 2, 3, Tiranë, 1967.

<sup>45</sup> Gjovalin Shkurtajt, *Vëzhgime rreth të folmeve të malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës dhe të Ishullit të Shëngjinit*, së pari, te Lissus I, f. 152, 172 dhe në formë më të gjerë te SF, nr. 4, Tiranë, 1972. f. 81-121.

<sup>46</sup> Gjovalin Shkurtajt, *E folmja e Hotit*, DSH, II, Tiranë, 1974.

<sup>47</sup> Gjovalin Shkurtajt, *E folmja e Kelmendit*, DSH, IV, Tiranë, 1982.

<sup>48</sup> Gjovalin Shkurtajt, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, DSH, IV, Tiranë, 1982.

\* Sigurisht se akademik Shkurtajt, për hartimin e këtij *fjalori*, pos studimeve dialektologjike që kishte bërë me herët, të një literature të gjerë studiuësish e hulumtimesh në terren, ka pasur parasysh edhe studimet e profesor Eqrem Çabejt, akademik Idriz Ajetit, “*Fjalor-in etimologjik*” të akademik Kolec Topallit, si dhe vepra e artikuj shkencorë të studiuesve anas, të Malësisë së Madhe, ndër të cilët: Gjergj Fishta, Nikollë Camaj, Gjovalin Gjeloshi, Gjekë Gjonaj, Gjergj Gjuravçaj, Mahir Hoti, Franjo Luli, Palok Luni, Marjan Lulgjuraj, Anton Lulgjuraj, Edmond Malaj, Lulash Palushaj, Nikolla Spathari, Tomi Treska, Nikë Ukgjini, Marenglen Verli etj.

shkëmbinj, shpella, kala, troje të moçme ose çfarëdo vendi tjetër që ruan më vete gjurmë lashtësie, pasuri kjo e cila po të mos gjurmohet e faktohet do të “bdarrej” – siç do të thoshte autori i *fjalorit* të parë shqip, Dom Gjoni i biri i Bdek Buzukut.

Edhe në *fjalorin* e akademik Gjovalinit, ashtu si edhe në studimet e tija analitike-sintetike dialektologjike, janë shpërfaqur njësitë e përbashkëta “dhe larmit dialektore të shqipes si në hapësirat dhe trevat shqiptare”, të cilat akademiku ynë i ka specifikuar\*, si:

1. *Fjalë që kanë kudo të njëjtën formë fonetike dhe të njëjtin kuptim*, të cilat edhe përbëjnë sasinë më të madhe të fjalëve të shqipes së sotme dhe të shqipes së moçme, siç janë foljet ose emërtimet e shumicës së veprimeve e gjendjeve;

2. *Fjalë me të njëjtin kuptim, por me forma fonetike të ndryshme*; (siç janë format morfologjike dhe sintaksore, bashkë me mjetet fjalëformuese, që dallojnë pikat kryesore ndërmjet dy dialekteve tona);

3. *Fjalë nga Malësia e Madhe që dallohen prerazi nga të folmet e tjera të grupit veriperëndimor dhe të mbarë gegërishtes* (për arsye të ruajtjes së togjeve *uo* dhe *ua*);

4. *Fjalë nga Malësia e Madhe që dallojnë nga të folmet e tjera të gegërishtes veriperëndimore, sa i përket disa dukurive fonetike* (alternimi i grupit bashkëtingëllor *nd>ll*: ndeze – lleze; dukuria e rotacizmit: *asnjani* – *asnjari*; alternimi i *v > b*: *avull* – *abull*; folja *kesh* – për kisha) etj.;

5. *Fjalë ose leksema të ndryshme për të emërtuar objekte ose veprime të njëjta* (fjalë kryesisht të moçme e që nuk ndeshen më as në të folmet e gegërishtes veriperëndimore, si *gërrçak*, *-u* “enë për të pirë verë”, *puçik*, *-u* “gropë e vogël nëpër rrasa e shkëmbinj të mëdhenj që mbushte me ujë nga shiu”), etj.

Një dorë mikrotoponimesh, të sjella në këtë *fjalor*, të cilat janë formuar sipas një paradigme kulturore (legjenda, ndodhi historike, etj.), të kujtojnë një përkufizim emblematic të profesor Eqrem Çabejt: “një njësi leksikore paraqet një njësi kulturore”, e kjo do të thotë edhe një njësi gjuhësore, etnografike dhe historike. Një përkufizim shumë saktësues. Në korpusin e këtij vëllimi ka shumë njësi leksikore, përkatësisht (mikro)toponimike, të cilat janë referenca të rëndësishme etnike (shqiptare, serbe, turke etj.), dhe shumë (mikro)toponime, natyrisht pos atyre shqipe, të cilat besohet se i takojnë fondit gjuhësor të sllavishtes apo turqishtes.

Studimet e mëtejme të këtij korpusi do të dëshmojnë se këto njësi, - sikur është shprehur profesor Mahir Domi: “*nuk hynë në fjalorin e shqipes si njësi toponimike, por si njësi leksikore, ndërsa u toponimizuan më vonë nga vetë shqiptarët, prandaj jo rastësisht ato na dalin të zhvilluara brenda strukturës fonetike dhe morfologjike të fonetikës dhe gramatikës historike të shqipes.*” Gjatë analizës së veprës na ranë në sy edhe disa fjalë të ashtuquajtura *fjalëshpejta*, që përdoren edhe sot për ushtrime të foluri për të vegjlit, e që përbëhen nga një pyetje dhe përgjigjet e thëna shpejt: “*A lafiq era, s’lafiqera, s’lalisera e jo lafiqera?!*” - A la fiq era, s’la fiq era, s’la lis era, e jo la fiq era.

Të tilla janë, ndër të tjera, edhe këto lojna fjalësh, *I ra:plûmi plakut te pragu. E shes thesin, s’e shes thesin, thesin s’e shes tha:t*. Në Kastrat, të vegjëleve u pëlqente shumë edhe kjo fjalëshpejtë: *A kjie? Po i kjeç. A j tha? Po jthaç. Si m’ tha i thaç, as s’ëm lla, as s’i llaç, si e gjeta, ashtu e laç; Plepi plak ka pa:lc pak, etj.*, me të cilat të fjalë, pos nevojës për ushtrim gjuhe, të vegjlit edhe sot zbaviten, por jo më sa e si me lojërat që i shikojnë në televizorët e sidomos në celularët e tyre.

I prirë nga dëshira për ta stërholluar dhe krahasuar mendimin e vjelë nga malësorët e “Nderit të Kombit”, e arealit të legjendës së misrit, apo për t’ia nxjerrë tharmin problemit të shtruar, siç më pati “tërhequr vërejtjen” para më se 20 vjetësh, në një studim timin, akademiku ynë, në këtë *fjalor*, nuk ka lënë pa përmendur edhe ndonjë gjëgjëzë që e ka dëgjuar dikur në atë anë, ose që “gjëllin” edhe sot në gojë e mendjet e malësorëve të atij krahu, sikundër është

---

\* Për shkak të natyrës së punimit, nuk po japim më shumë shembuj, të cilët janë të paraqitur në *fjalor*.

rasti me shembujt: *Ara e ba:rdh, fara e ze:z, e mjell me do:r, e ko:rr me go:j.* (Gjëegjëzë: letra e shkruar). *Dy zoja t'lyeme, n'i o:d t' nry:me, motra jâ:n e shoqashoqen nuk e shohin* (gjëegjëzë për veshkët-veshkat e njeriut). *Pê:s t'bi:t e dorakut, e kapin t'bi:n e hunakut e qiesin jasht praktik.* (Gjëegjëzë: të bijt e dorakut (gishtërinjtë e dorës), të bi:n e húnakut (të bijën e hundës=qurrat) i qesin jashtë praktik (I nxjerrin jashtë pragut të derës). *Kallaj mrê:n e kallaj ja:sht, zerdeli e pilaf ba:shk. E bija delë n'paza:r, e âma rrin kacavar:r.* (Gjëegjëzë për rrushin: vilja del në pazar, kurse e ama (hardhia) mbetet në vend).

Se me çfarë përkushtimi iu ka rrekur studimit të të folmeve të popullatës së atyre fshatrave e qytezave, kodrave e maleve, akademik Gjovalini e justifikon me një fjali në përmbyllje të *Fjalës paraprijëse*, kur thotë se këtë vepër “*Ia kushtoj, pra, me shumë përvujtëni e nderim Malësisë dhe malësorëve të mi*”. Krahas një fondi aq të pasur dhe të mëvetësishëm fjalësh, njësisht leksikore e frazeologjizma, sintagma e shprehje të ngurtësuar fjalësh, fjalë të urta, si: *Çka âsht i he:r nuk âsht përhe:r, N' kjo:ft se nuk mu:jm si duom, na do t' bâjm si mu:jm...;* përshëndetje: *A jie bu:rr! A jie burrne:sh! A jie fisnike! Lamtumi:r, miq e kuma:r, lamtumi:r male e qeta, lamtumi:r për sa t'jiet jeta* - Nga një vajtim burrash në Kastrat); mallkime: *T'hâgërt dreqi eshtnit!, Ia falsha dreqit!, T'ra:ft molldraga! T'shitofz zana e malit!...;* urime: *Mos i pa:t syni i keq!, Kush t' pa:t me ne:r ta g-jatt!, Ta njesha zânin e mi:r!...;* zbunime të shumta (si objekt të etnolinguistikës), si dhe etnonime, patronime (disa nga të cilat janë paraqitur më poshtë), të vjela e “të kokërruara” nga akademiku Shkurtaç, me aq përkushtim e dije. Në *fjalorin* e tij, ka dalluar edhe shumë fjalë të huaja, që po i quajmë huazime, e që nuk i kthyem kurrë si të tilla, nga atje ku janë marr, si p.sh.:

- *Fjalë nga turqishtja: ba:b-baba, baklla:v-bakllava, da:j-daja, kafe- kaffja, nalet, Qabe, penxhère-penxhèrja, tenëqe-tenëqja, káurr-káurri, qoshe-qoshja, xhade-xhadja* e shumë fjalë të tjera të cilat në toskërisht kanë theksin kryesisht në rrokjen fundore ose parafundore.

- Fjalë me prejardhje na sllavishtja: *Lubo, Nashkeja, Pero; pobratin/probatin, kukat; vrâç (kalë i zi); boronicë-a* (qershizë); folja *ivikas* (nga *vikat*) ; ojkonimet: *Dushiq-i, Kamicë* (buzë liqenit të Shkodrës); *Gradec-i* (lagje e Kastratit) etj.

- Fjalë të krijuara nën ndikimin e italishtes, ku hynë, kryesisht, emrat me prapashtesën – *in/ë* (*Angjelin, Gjovalin, Pavlin, Pjerin, etj.*), *Tonin* Kaçaj (Bajzë-Kastrat), *Tonin* Marina (Koplik), *Tonin* Palok Luketa (Grishaj-Shkrel), *Palinë, Gjystinë, Gjyzepinë, Jozefinë, Zefinë, etj.*

- Nga latinishtja, me shndërrimin e *c > th*; *acer > (i, e) athët, c > q: cedrum > qitër, s > sh: asper > ashpër, angustus > (i, e) ngushtë, k > q: caelum > qiell, x në fsh e sh: coxa > kofsha e kosha* etj.

Numri aq i madh i fjalëve në këtë *fjalor*, që flinin të qeta ndër shekuj në atë areal të shqipes, tani të (ri)trazuara dhe pasuruara nga pena e hollë e akademik Gjovalinit, do të jenë të mirëseardhura për pasurimin e fjalësit të shkollarëve, mësuesve, gazetarëve, shkrimtarëve, gjuhëtarëve e dashmirëve të tjerë të gjuhës shqipe, ngase një mori fjalësh të huaja të përdorura edhe tani nga këto shtresa intelektualësh dhe të tjerë, mbështetur në këtë fjalës të hartuar me akribi të rrallë nga akademiku ynë, do të mund të zëvendësojnë shumë fjalë të huaja të panevojshme për shqipen.

Këtë bindje tonën e mbështesim edhe në një thënie të studiuesit e leksikografit të shquar, Miço Samara, i cili ka pohuar se “*Trualli ynë amtar fsheh një thesar të tërë fjalësh të bukura shqipe, të cilat mund të zëvendësojnë lehtësisht disa nga fjalët e huaja, që përdoren pa nevojë e disa herë edhe nga mania për t'u dukur ose për të folur me “fjalë të mëdha” të pakuptueshme për një masë të gjerë të popullit*”<sup>49</sup>. E se duhet vjelë këtë lëndë aq të rëndësishme, po përmendim edhe një testament të akademik Idriz Ajetit, i cili porositi: “*Regjistrimi i leksikut ndër dialekte e të folme, vjelja e tij nga literatura e botuar janë një ndër punë të mëdha për t'u kryer*”.

<sup>49</sup> Shih: Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, IA, Prishtinë, 2018, faqe 3.

Njësitë leksiko-gramatikore, janë materializuar e faktuar nga të gjitha anët studimore të tyre, me shumë shembuj të përzgjedhur, siç shihet edhe nga shembëllzimet e paraqitura në *fjalor*. Do t'i hynim në hak, mbase, sikur të mos përmendnim edhe dy vlerësime shumë serioze e të thuktë të dy recensuesve të *fjalorit*, të dy studiuesve të dalluar në fusha të ndryshme të albanologjisë e në veçanti të leksikografisë. Derisa prof. dr. Valter Memisha, duke vlerësuar *veprën* në fjalë, jep një mesazh shumë domethënës se “*Fjalori krijon mundësi të shumta për sipërmarrje studimore më të gjerë e më të plotë (madje dhe në nivel doktoraturash) në fushën e fonetikës e të gramatikës dialektore, për studime sinkronike dhe ato diakronike, për studime etnolinguistike e etno-kulturore, si një burim i rëndësishëm për Fjalorin e madh normativ të shqipës, por edhe për fjalorin e saj të ardhshëm “tesaurus”*; recensuesi tjetër, prof. dr. Tefë Topalli, për këtë vepër veçon se “*Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*”, si për nga vlerat mirëfilli studimore, ashtu edhe nga prurjet konkrete nga hulumtime të bëra në vendbanime të ndryshme të Malësisë, dhe në vendet e tjera ku janë shpërngulur malësorë ... përbën një ndihmesë me vlerë për kërkimet në lëmin e dialektologjisë dhe të sociolinguistikës shqiptare“, me vlerësimet e të cilëve studiues, nuk di se kush nuk do të pajtohej.

Nga analiza dhe vlerësimi i këtij korpusi të begatë fjalësh, kemi hartuar një pasqyrë, me fjalë klasash të ndryshme: emra, mbiemra, më pak numëror e përemra; folje, ndajfolje, e po ashtu edhe ato pjesë të ligjëratës që ishin më pak të shprehura në *fjalor*, si: parafjalë, lidhëza, pjesëza, pasthirrma; onomatope etj. Të dhënat e paraqitura në pasqyrë, pos llojeve të pjesëve të ligjëratës, shprehin edhe dendurinë (frekuencën) e fjalëve të gjetura në pjesën e Shqipërisë së Veriut, përkatësisht në atë të Malësisë së Madhe dhe në disa tërthore anësore, përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në Mal të Zi (Gruda, Trieshi, Rapsha e Traboini i Hotit). E bëmë këtë punë, jo dhe aq të lehtë, për të shpërfaqur më detajisht përfaqësimin e çdo klase të njëjësive leksikore në makrostrukturën e këtij *fjalori*.

### Pasqyrë e dendurisë së leksemave sipas rendit alfabetik dhe njëjësive leksikore

Shk r.	Emri		Mbi e	Nu m	Për em	Fol.	Nda j	P.fj al	Lid h	Pjes	Pas th	On o	As.	Nyj ë	Euf .	Gjit h	%
	M.	F.															
A	98	75	25	-	15	21	60	-	5	4	16	-	2	-	2	343	2,78
B	337	339	174	-	-	101	47	4	1	7	16	3	2	-	2	1033	8,39
C	78	73	21	-	4	36	19	-	-	-	4	-	-	-	1	236	1,91
Ç	93	93	65	-	15	121	22	-	2	1	5	-	-	-	1	418	3,40
D	199	204	70	2	8	90	45	3	14	3	6	1	4	-	1	650	5,27
Dh	18	24	18	-	-	7	-	-	-	-	-	-	1	-	1	69	0,56
E	23	23	10	-	2	14	8	-	2	1	10	-	1	1	1	96	0,77
Ë	1	5	1	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	1	10	0,08
F	104	146	66	-	1	53	24	-	-	-	9	-	4	-	1	408	3,31
G	160	196	68	-	-	95	31	-	-	2	3	-	2	-	2	559	4,54
Gj	78	45	23	3	13	21	19	-	-	1	-	-	1	-	-	204	1,65
H	141	95	63	-	-	50	25	-	1	-	21	-	2	-	-	398	3,23
I	35	16	9	2	-	8	7	2	-	-	5	-	-	-	-	84	0,68
J	32	19	7	2	13	7	17	1	-	2	5	-	1	-	-	106	0,86
K	386	354	140	3	26	140	105	1	3	2	22	-	3	-	2	1187	9,64
L	180	170	75	-	-	77	14	-	-	1	18	-	1	-	-	536	4,35
Ll	27	7	15	-	-	16	1	-	-	-	-	-	-	-	-	66	0,54
M	268	288	95	-	2	97	48	11	2	7	22	-	-	-	1	841	6,83

N	96	107	47	7	2	50	26	8	5	3	4	-	3	-		358	2,90
Nj	2	9	5	1	7	11	5	-		-	-	-	1			41	0,33
O	23	19	5	-	-	-	3	-	2	-	8	-	-	-		60	0,49
P	269	265	187	5	2	215	112	20	9	4	24	-	8	-	2	112 2	9,11
Q	89	61	25	-	2	29	14	-	1	-	12	-	2	-		235	1,90
R	46	47	20	-	-	24	8	-	1	-	2	-	-	-	1	149	1,21
Rr	68	92	7	-	-	53	43	3	-	-	1	-	1	-	1	269	2,19
S	176	157	63	-	5	41	25	2	-	1	1	-	1	-		472	3,83
Sh	198	218	97	5	-	115	46	-	-	-	3	-	5	-		687	5,59
T	162	132	62	4	9	79	66	3	4	-	14	-	10	-		545	4,42
Th	35	32	18	-	-	33	6	-	-	-	-	-	-	-		124	1,00
U	40	33	11	-	2	14	3	-	-	1	4	-	3	-		111	0,90
V	138	131	77	1	2	58	31	1	2	2	5	-	-	-		448	3,64
X	5	5	6	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1	-		18	0,15
Xh	39	20	14	-	-	28	5	-	-	-	-	-	-	-		106	0,86
Y	10	1	-	-	3	-	-	-	-	-	1	-	-	-		15	0,12
Z	72	59	40	-	-	41	7	-	-	1	1	-	2	-		223	1,81
Zh	21	22	10	-	-	27	3	-	-	-	-	-	1	-		84	0,68
GJI TH	374 7	358 2	163 9	35	133	177 4	896	59	54	43	242	4	62	1	40	123 11	100 %

Nga të dhënat e fjalëve të paraqitura në këtë pasqyrë, të nxjerra nga *fjalori*, del se më së shumti ka emra: 3747 të gjinisë mashkullore dhe 3582 të gjinisë femërore, gjithsej = 7329 (59,53%); folje = 1774 (14,40%); mbiemra = 1639 (13,31); ndajfolje = 896 (7,27), sakaq, me denduri më të madhe paraqiten fjalët që fillojnë me shkronjat: K = 1187 (9,64%), P = 1122 (9,11%), B = 10,33 (10,8,39%)..., e më së paku denduri (frekuencë) kanë ato fjalë, që fillojnë me nistoret: Ë = 10 (0,08%)\*<sup>50</sup>, Y = 15 (0,12%), X = 18 (0,15%), e kështu me radhë, nga një korpus prej 12311 njësisish leksikore, edhe pse fonema **ë**, në fjalët e gjuhës shqipe, bashkë me fonemat **a**, **e** dhe bashkëtingëlloret **n**, **r**, **t**, kanë dendurinë më të madhe.

Fjalët në këtë *fjalor*, për nga struktura e tyre fjalëformuese, janë kryesisht fjalë të parme: *byk*, *d:itë*, *allti*., *gardh*, *habi*, *ledh* (lell), *mjel* etj., por të shumta janë edhe leksemat e prejardhura (me parashtesa e prapashtesa), fjalët e përbëra (kompozitat) dhe diçka më pak fjalët e përngjitura, siç shihet edhe nga shembujt e dhënë:

- Fjalë me parashtesa: *pici*:- *picigjate*“e stërzgjatur”, *picigul* /*picingul*“ kokëposhtë, kokëtatëpjete”; me parashtesën lara-, kryesisht mbiemra që tregojnë ngjyrën e larme si laracik boret “zog i larmë”, *laramân*, -e“për lopë a qe të larmë”; me parashtesën nar- (ndër-), në formimet e emrave *narsjetull*, -a, *narbarke*, *narbishte*, si dhe në emërve te mikrotoponimet: *Narmegja*, *Nardrûme*, -t, *Narvorret*, po edhe te toponimet, si: *Narshkodër*, si edhe etnonimet *narshkodrak*, -u e *narshkodrake*, -ja.; me parashtesën dë-: forma e foljes *dëboj*; me parashtesën ka-: *kaçu*:-b (flokë të gjatë të meshkujve në pjesën e përparme të ballit), dhe te *kabisht*, -I “gërshërëz”; me parashtesën pa- dhe nyjën e përparme: *i paërz*, e *paërze*; me parashtesat deiktike: je- *jekaq*, *qekaq* (në brezin e vjetër), *jejekhâ*, si te shembulli: *Ku e ke martua vajzën? Paj*, *jekhâ n’Shkrel*; *jeksajt*; me parashtesën nër- (ndër-) në formimin e ndajfoljeve: *nërmjet*, *nërdyash*, *nërgishte*; me parashtesa stër-: *stërnip*, -i, *stërgjysh*, *stërmbesë*; me parashtesën pa-me të cilën formohen mbiemra të nyjshëm, si: *pa:mir* (i, e), *pa:burr* (i, e), *pa:emën* (i, e) etj.

\* Si nistore fonema **ë** del më së paku në fjalët e gjuhës shqipe, nga të gjitha shkronjat e tjera, edhe pse në tërësi, bashkë me fonemat **e**, **a**, ka frekuencën më të lartë në leksikon e gjuhës sonë, ashtu si dhe bashkëtingëlloret **n**, **r**, **t**

- Fjalë me prapashtesa, si: -acak-e: *frigacak-e*; -ac-e: *tollac-e*; -a:çe: *luvda:ç-e*, -ak-e: *curak -e*; -aloç: *bregaloç*; -an: *galan-i*, -a:s-e: *doras-e*; -ash, me të cilën në të folmet e Malësisë formohen forma të dyta të emrave vetjakë, kryesisht zbulime a nofka, si: *Lulash*, *Mirash*; -aza: *g-jûjaza* (gjunjazi); -esh(ë): *sokole:sh*, *dasmore:sh*, *rrogtare:sh*; -im; *bashkim-i*; -i:sh/ë: *balish*; -shim: *hieshim*; -ne:sh: *burrne:sh*, *trimne:sh*; -u:j: *gërmusu:j* (< gërmus “e kërrusur”); disa zbulime a nofka me prapashtesa të tjera: aç: *Pjetraç*; -ash: *Lulash*, *Marash*; -inë: Jozefinë; -ush: *Hajrush*; -oc: Bardhoc; -ul/ë: *Hanulë*; -ot: Malot; -uk: *Hiluk*; disa patronime e etnonime, me -ja: *Gjeloshja*, *Martinja*; -aj: *Camaj*; me kuptim zvogëlues: -i:cë: budalli:cë; -th: *qokth-i*, etj. etj., si dhe:

- Fjalë të përbëra (me kompozim), me dy a më shumë gjymtyrë: *babagjysh*, *bablok*, *bishtcubel-e*, *çehermadh* “serioz, i rreptë”, *emënharruom -e*, *faqerreshkun*, *flokkaçurrel-e*, *gjakze:t*, *hûnshpatuk*, *skjepshpatuke*, *kryebabûne* “kokëmadh”, *kryepre:m*, *lkurtra:sh*, *trû:tra:sh*, *mjekërsjap*, *syzi*, *syrrush-e*, *nânba:be-ja*; *eufemizmi gjofterrfeja*; patronimet: *Lulgjuraj* (Traboin-Hot), *Gjuravçaj*, *Shabalukaj* (Kushe-Hot); etnonimet: *Bajrokurtaj*, *Çeskdedaj* (Shkrel); *Gegvata*, *Gegisen*; *Gjekmarkaj*, *Gjekmuçaj*; *Gjetodedaj*, *Uldedaj* (Kastrat), *Marlekaj*, *Leknikaj*, *Lekbibaj*, *Lekdush*, -i; toponimet: *Qafdashi* (në Dedaj - Shkrel), *Markatomaj* (fshat në Lezhë); patronimi: *Dyldoshaj-t*; ndajfoljet: *kamkî:z*, *pardje*, *tepardje* etj.

- Fjalë të përngjitura: *ferrgomare*, mbiemri *kâmbajmak-e*, *shtatselvi:;* etnonimet: *Dedgjonaj*, *Lucgjonaj*, *Margjonaj* (në pjesën e Malësisë në Mal të Zi), *Marlekaj*, *Vuksalekaj* (Hot), *Leknikaj* (Shkrel); patronimet: *Markola*, *Marleka*, *Margjekaj*, *Marvukaj*, *Selgjiëkaj* (Koplik), *Selhâni* (Shkodër); toponimet: *Nërshelivad/e-ja*, *Përtesadet* (ara në Pjetroshan), *Përrerrugja* (arë në Pjetroshan), *Pibrrake*, *Pidrume*; pasthirrmat: *makeq-e-mâ*, *zi:-e-mazi:* etj.

Në *fjalor* janë përfshirë edhe një numër i konsiderueshëm *togfjalësha*: *me tërrnuo çehre* “ndërron faqe, zbehet a zverdhet”, *konil* (kandil) *bishtuk*, *e ka zanad* “e ka ves, e ka traditë”, *a:rr zhiçel* “arrë pa bukë” etj., si dhe *frazologjizma* të shprehur me një tërësi togjesh dhe thënie a shprehje të qëndrueshme, të pandashme nga ana leksikore, të njësishtme, të mëvetësishtme e gjithnjë të figurshme, si, p.sh.: *Barku â i villau i detit* “barku është si deti”. *E mushi/ bushi barkun. Ia bâj shpinën ma t’bu:t se barkun. Pëlhurës* (stofit) *shikoji anën, vajzës shikoji nanën. Mos u zëni si Na:rkajt për ulli t’ qiells!* e të tjera si këto.

Po përmendim këtu edhe një *fjalë të palakueshme*, siç i ka quajtur autori *fjalët: pardan* (pardon – me kuptimin kërkoh falje, kërkoh ndjesë), *zbeh* (gjë e papritur, surprizë e madhe: *Jekjo punë në zbeh m’ka ra*), *razi* (kandisem, pranoj, jap pëlqimin: *Syni i zi: me razi:*), *telef* (lodhem shumë, sfilitem), *zap* (e pengoj të veprojë e të kryejë punë të këqija: *Ky kryetari i ri i ka bâ zapdemelat*). Mbi 12300 zëra, të shtrirë në 1014 faqe të formatit 17 x 21 cm., të përmbledhur në *fjalor*, janë shënuar sipas shqiptimit në të folmet përkatëse, me shenjat diakritike që i njeh dialektologjia e shqipes dhe janë radhitur sipas alfabetit të gjuhës shqipe, pjesën dërrmuese nga të cilat e përbëjnë, siç kemi theksuar edhe më sipër: emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet, pastaj pjesëzat dhe pasthirrmat, pa përjashtuar edhe ndonjë tip fjale tjetër më të rrallë.

Për hartimin e këtij *fjalësi* dhe nxjerrjen e shembujve për përdorim në ligjërimin e lidhur (të shkruar a të folur) janë shfrytëzuar një numër i madh burimesh, mbi 240 vepra shkencore, letrare, publicistike etj., dhe mbi 90 autorë anas nga Malësia dhe shkrime kryesore për të, të dhëna këto të cilat janë pasqyruar në bibliografinë përkatëse të *fjalorit*. Ndërkaq, si burime gojore (nga informatorët), autori i *fjalorit* përmend 58 vetë, “nga të cilët janë regjistruar tekste relativisht të gjata ose që kanë dhënë përgjigje në anketimet e kryera për mbledhjen e materialeve për studimet e të folmeve të Malësisë së Madhe” dhe 20 informatorë të tjerë “prej të cilëve kemi shënuar emra vendesh dhe emra njerëzish” thotë akademiku Gjovalin Shkurtaj.

Njësitë leksikore në këtë *fjalor*, janë paraqitur me 4 lloje shkronjash. Me shkronja të mëdha të kuqe (bold - fjalëve përfaqësuese); me të pjerrëta (italik-e, të pa nxira - akronimet), për gjininë e emrit dhe për të treguar se ç’ pjesë ligjërata janë ato fjalë, si dhe fjalët origjinale të

shënuara si shembuj nga burime të caktuara; me shkronjë të vogël e të zezë (bold) është pikasur fjala që gjendet mes shembujsh, e me shkronja normale janë dhënë shpjegimet – domethënia e fjalës. Numri arab është vënë, pas pak fjalësh, kur fjala ka pasur më shumë se një kuptim, duke treguar se sa herë është përsëritur fjala e tillë, si njësi homonimike.

Në fund të disa fjalëve të vjela është treguar edhe burimi i vendit të leksemës, por jo gjithnjë, sigurisht që të mos stërngarkohet *fjalori* me aq shumë emra fshatrash e qytezash, kurse autorët e vjetër dhe të tjerët, si dhe literatura nga është vjelë fjala, janë shënuar drejt dhe me saktësi të plotë. Po theksojmë edhe këtë se autori, në këtë *fjalor*, me theksin hundor ^ mbi shkronjë, ka dalluar zanoret hundore (nazale), kurse ato të gjatat i ka shënuar me dy pika: pas zanores së gjatë, siç praktikohet zakonisht në studimet dialektologjike ose edhe te fjalorët e tjerë shpjegues të gjuhës shqipe dhe fjalorë të huaj.

Me këtë korpus voluminoz leksemash, shprehjesh, frazeologjizmesh... që ka *fjalori*, të përzgjedhura e të trajtuara me sens nga autori, një punë titanike që edhe një ekip ekspertësh do t'ia kishte zili, na obligon të falënderojmë e përgëzojmë akademik Shkurtajn, me shpresë se do të na gëzojë edhe me ndonjë vepër tjetër nga fushat albanologjike që ai u del zot si rrallëkush tjetër. Edhe ne, e sigurisht se edhe Shkurtajn, e di se asnjë fjalor, sado i vëllimshëm që të jetë, nuk mund të përfshijë gjithë fjalësin e një areali a të një gjuhe, aq më parë kur dihet se njësi të tilla leksikore shtohen përherë, ngase gjuha nuk është një proces i përfunduar (një ergon), por (një energie), strukturë e hapur në kuptimin modern sipas konceptit të Humboldt.

Në fund, na mbetet ta përgëzojmë dhe njëherë autorin për këtë kontribut të ri e shumë të rëndësishëm, i cili, jo vetëm veten, por e nderon edhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, duke i shtuar varganit të veprave të saj e të tij edhe një vepër të madhe, një *fjalor* me mbi 12 300 leksema, që rrokin përmasat e mbi 1000 faqeve. Në përmbyllje të këtij shkrimi modest, po shpërfaqim një amanet (paksa nostalgjik) të autorit, i cili *Pasthënien e fjalorit* të tij e përfundon “me një varg të këngës malësorçe, që thotë: “*Kaq e dita, kaq e thaç, merrnje ju tie:rt, se jua laç*“, e me të cilin varg e mendim ne nuk do të pajtoheshim kurrë. Unë do t'i thosha profesorit e mikut tim me plot gojë e zemër: Jo, profesor, jo! Ju na duheni ende neve e i duheni edhe më shumë gjuhës shqipe. Ju dhe profesor Emili do ta ndiqni rrugëtimin – jetëgjatësinë e akademik Ajetit, të cilin e keni dashur dhe për të cilin keni shkruar aq shumë, andaj, dashtë Zoti, jetofshi sa Ai e më shumë se 102 vjetët e Tij! Ashtu qoftë!

## Referencat

- [1]. Jashari, Prof. dr. Ali, *Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2020.
- [2]. Shkurtajn, Gjovalin, *Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe*, Tiranë, 2021.
- [3]. Shkurtajn, Gjovalin, *E folmja e Kastratit*, Studime filologjike, nr. 2, 3, Tiranë, 1967.
- [4]. Shkurtajn, Gjovalin, *Vëzhgime rreth të folmeve të malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës dhe të Ishullit të Shëngjinit*, së pari, te Lissus I, f. 152, 172 dhe në formë më të gjerë te SF, nr. 4, Tiranë, 1972.
- [5]. Shkurtajn, Gjovalin, *E folmja e Hotit*, DSH, II, Tiranë, 1974.
- [6]. Shkurtajn, Gjovalin, *E folmja e Kelmendit*, DSH, IV, Tiranë, 1982.
- [7]. Shkurtajn, Gjovalin, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, DSH, IV, Tiranë, 1982.
- [8]. Murati, Qemal, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, IA, Prishtinë, 2018.
- [9]. Memishi, Prof.dr.Valter, *Fjalë përurimi në Universitetin “F. S. Noli” për veprën “Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2020, të prof. dr. Ali Jasharit, Korçë, 19 prill 2021.
- [10]. Zymberi, Abdullah, *Fjalor popullor* (me rreth 20 000 fjalë), Prishtinë, 2014.